



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDHËM TË CILËSISË
SEKTORI I KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDHËM TË CILËSISË

Prot.....Nr. 453

Korçë, më 12/02/2025

RELACION PËR PYETËSORIN STUDENTOR

Në muajin qershor 2024, anëtarët e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me Sektorin e Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni kanë zhvilluar pyetësin studentor, pyetjet e të cilit janë hartuar dhe rishikuar sipas përcaktimeve ligjore.

Pyetësi është shpërndarë në e-mailet zyrtare të të gjithë studentëve aktualë të UNIKO.

Pas përfundimit të periudhës së caktuar për plotësimin e tij, të dhënat e mara janë filtruar sipas fakulteteve dhe u janë dërguar koordinatorëve të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë për secilin fakultet të cilët bënë raportet përkatëse.

Pyetësi përbëhet nga gjithsej 17 pyetje, të ndara si më poshtë:

-Pyetje të mbyllura: Pyetjet më të shumta ishin me opsione të caktuara përgjigjesh, duke përfshirë alternativa si "Po" dhe "Jo", vlerësime nga 0 deri në 5, dhe deklarata që kërkonin pajtim ose mos-pajtim.

-Pyetje të hapura: Studentët kishin mundësinë të jepnin komente të detajuara për raste konkrete, si performanca negative e pedagogëve dhe rastet e korrupsionit.

-Pyetje vlerësuese: Kishte pyetje që kërkonin vlerësime numerike për faktorë të ndryshëm që ndikojnë cilësinë e mësimdhënies dhe shërbimeve mbështetëse.

-Pyetje etike: Pyetjet për çështje delikate si korrupsioni u dhanë studentëve mundësinë për përgjigje anonime, duke siguruar sinqeritetin dhe privatësinë.

Ky relacion përfshin të dhënat e nxjerra nga pyetësi dhe raportet e analizimit të të dhënave për të katër fakultetet, të cilat përmbledhin perceptimet dhe vlerësimet e studentëve lidhur me përvojën e tyre akademike, cilësinë e mësimdhënies, infrastrukturën, dhe mbështetjen akademike që ofrohet.

Gjetjet kryesore të relacionit synojnë të identifikojnë fusha për përmirësim të vazhdueshëm dhe të kontribuojnë në hartimin e planeve të veprimit që nxisin përmirësime në praktikat mësimore dhe administrimin e përgjithshëm të fakultetit.

Raporti gjithashtu përmban rekomandime për strategjitë që do të ndihmojnë në ngritjen e standardeve të cilësisë dhe përsosjen e përvojës së studentëve në të ardhmen.

Përkatësisht pyetësi u plotësua nga **383** studentë pjesëmarrës nga **2336** studentë të UNIKO, ku **191** studentë ishin nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, **100** nga Fakulteti i Ekonomisë, **72** nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe **20** nga Fakulteti i Bujqësisë.

Në total rezultojnë se pyetësi është plotësuar nga **16.3%** e studentëve aktualë për vitin akademik 2023-2024.

Nga shpërndarja e pyetësorit kemi marrë të dhëna nga të gjitha ciklet dhe vitet e studimit si edhe nga të gjitha programet e studimit.

BA 64% MP dhe MSC 25% PP 11%

VITI I 44% VITI II 40 % VITI III 16%

Zhvillimi i mësimi ose vlerësimit të bazës mësimore (tekste bazë, tekste ushtrimesh, literaturë ndihmëse, internet, bibliotekë)

Rreth zhvillimit të mësimi ose të vlerësimit të bazës mësimore (tekste bazë, tekste ushtrimesh, literaturë ndihmëse, internet, bibliotekë), nga rezultatet e nxjerra nga ky pyetësor, nëse bëjmë një mesatare të përgjigjeve vihet re që studentët janë përgjigjur: Shumica e studentëve e vlerësojnë cilësinë e materialeve mësimore dhe teknologjisë si të kënaqshme ose më të lartë, gjë që është një tregues i mirë për standardet aktuale të universitetit. Megjithatë, një përqindje prej rreth 20% e studentëve ka raportuar përvoja më të ulëta.

Rreth 70-80% e studentëve kanë përvoja pozitive ose shumë pozitive, duke reflektuar një përdorim të kënaqshëm të internetit në funksion të mësimdhënies pjesa tjetër dëshmon për ekzistencën e sfidave ose mungesave në përdorimin efektiv të internetit për qëllime mësimore.

Kjo nënkupton nevojën për investime në infrastrukturën teknologjike, trajnime për pedagogët për përdorimin e mjeteve digjitale dhe rishikim të politikave të përdorimit të internetit për të maksimizuar përfitimet e tij në procesin mësimor.

Performanca e pedagogëve

Pyetjet përbëhen nga pesë kritere vlerësimi, duke përfshirë përdorimin e metodave të efektshme të mësimdhënies, atmosferën në auditor, kompetencat profesionale të pedagogut, menaxhimin e kohës gjatë orëve mësimore dhe vlerësimin e studentëve. Përqindja më e lartë e përgjigjeve në të gjitha aspektet është mbi mesataren me **“Mirë”** dhe **“Shumë Mirë”** në masën **70-90%**, që do të thotë se pavarësisht performacës pozitive ka vend për përmirësim pasi rreth **10-30%** japin përgjigjen **Mjaftueshëm/Keq**.

Performanca e pedagogëve në të gjitha fakultetet vlerësohet pozitivisht nga shumica e studentëve, veçanërisht për kompetencat profesionale, zërin dhe respektin ndaj

studentëve. Megjithatë, elementet si efektiviteti i metodave të mësimdhënies, përdorimi i mjeteve mësimore dhe lidhja teori-praktikë kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme. Përpjekjet për të adresuar këto fusha do të kontribuonin në rritjen e cilësisë së përgjithshme të mësimdhënies dhe përvojës studentore.

Nevoja për literaturë shtesë:

45-65% e studentëve deklarojnë se kanë nevojë për literaturë shtesë, ndërsa 35-55% nuk e ndjejnë këtë nevojë. Ky fakt tregon se për një pjesë të madhe të studentëve, literatura bazë e përdorur në lëndët e tyre nuk është e mjaftueshme. Prandaj, është e rëndësishme që pedagogët të ofrojnë burime të tjera shtesë për të thelluar njohuritë dhe për të përmirësuar përvojën akademike të studentëve.

Raste pedagogësh që kanë performancë negative

Në lidhje me pyetjet e hapura që japin informacion për raste të pedagogëve që kanë performancë negative në një nga pyetjet që lidheshin me vlerësimin e performancës së pedagogut përmbledhen në disa kategori që kanë të bëjë në mënyrë të përgjithshme me:

-Disa pedagogë, siç përmenden nga studentët, kanë shfaqur qëndrime tallëse ose ofenduese, duke krijuar një atmosferë të pakëndshme për të mësuar. Kjo sugjeron se ka hapësirë për të përmirësuar qasjen dhe sjelljen ndaj studentëve, duke garantuar një mjedis respektues dhe mbështetës.

-Studentët kanë theksuar mungesën e një balancimi efektiv midis teorisë dhe praktikës, gjë që ndikon në cilësinë e përvojës së të nxënies. Pjesa teorike përmendet shpesh si e tepert ose jo e dobishme pa komponentën praktike.

-Raportohet se disa pedagogë kanë munguar ose kanë mbërritur me vonesë në orë mësimi, ose kanë kaluar shumë kohë në aktivitetet personale, si përdorimi i telefonit, në vend që të angazhohen me studentët. Kjo reflekton nevojën për të rritur disiplinën në menaxhimin e kohës dhe për të siguruar që të gjitha orët e planifikuara të realizohen në kohë.

-Disa studentë vlerësojnë negativisht përgatitjen dhe metodologjinë e përdorur nga disa pedagogë, duke përmendur përgatitje jo të mjaftueshme.

FSHNSHH

-Disa pedagogë, siç përmenden nga studentët, kanë shfaqur qëndrime jokorrekte, në disa raste përdoren fjalë banale ose ofenduese, duke krijuar kështu situata të pakëndshme për zhvillimin normal dhe korrekt të orës mësimore. Kjo sugjeron se ka hapësirë për të përmirësuar veprimet dhe sjelljen ndaj studentëve, duke garantuar një mjedis respektues, bashkëpunues dhe mbështetës.

-Raportohet raste dhe emra pedagogësh, të cilët për arsye nga më të ndryshmet, kanë munguar ose kanë mbërritur me vonesë në orë mësimi, ose kanë kaluar shumë kohë në veprimtari personale, jomësimore, si përdorimi pa vend i telefonit, në vend që të angazhohen në situata mësimore në varësi të orës mësimore me studentët. Kjo reflekton nevojën për të rritur edhe më shumë disiplinën në aspektin e menaxhimit korrekt të kohës dhe për të siguruar që të gjitha orët e planifikuara të realizohen në kohë.

-Disa studentë evidentojnë madje edhe sjellje arrogante dhe raste korrupsioni.
-Përmenden raste kur pedagogu nuk pranon të rishpjegojë dhe ri interpretojë elementë të caktuar të mësimi, të cilat nuk janë kuptuar qartë dhe saktë nga studentët gjë e cila çon në uljen e efektivitetit të orës mësimore, leksione apo seminare.
-Gjatë analizës së të dhënave të pyetësorit konstatova edhe përgjigje dhe vlerësime të papranueshme, disa etiketime dhe fyerje nga ana e studentëve në drejtim të pedagogëve.

Të gjitha këto kostatime dhe evidencime, NJBSC e Fakultetit do t'i prezantojë në raportin përmbledhës të dekanatit, i cili do të diskutohet me stafin akademik për përmirësime të mëtejshme, në analizën vjetore, nga ku do të dalin edhe sygjerimet e nevojshme për të ardhmen.

Vlerësimi mbi literaturën e përdorur

Në përgjithësi, nga të dhënat duket se studentët kanë pjesërisht nevojë për literaturë shtesë dhe sugjerime nga pedagogët pasi në përgjithësi literatura është e mjaftueshme, por kanë hasur vështirësi në kuptimin e materialeve të dhëna. Sidoqoftë, shumica e studentëve pajtohen se përdorimi i literaturës shtesë ka ndihmuar në zgjerimin e njohurive dhe lidhjen e saj me tematikën e kursit ka qenë e rëndësishme. Gjithashtu, ata pajtohen se detyrat e kursit krijojnë aftësi praktike të dobishme.

Përdorimi i literaturës shtesë për thellimin e njohurive:

70-75% e studentëve pajtohen se literatura shtesë ka kontribuar në thellimin e njohurive të tyre, ndërsa 25-30% nuk e konsiderojnë këtë si të dobishme. Kjo tregon se literatura shtesë ka një ndikim të dukshëm pozitiv për shumicën e studentëve, duke e bërë të domosdoshme përfshirjen dhe rekomandimin e më shumë burimeve të tilla nga pedagogët për të përforcuar materialet mësimore.

Ndihma e lëndëve për kualifikim me njohuritë e nevojshme:

80-90% e studentëve pajtohen se lëndët i ndihmojnë të kualifikohen me njohuritë e nevojshme, ndërsa 10-20% kanë një mendim të kundërt. Kjo përqindje e lartë e dakortësisë tregon se përmbajtja e lëndëve është kryesisht efektive në përgatitjen e studentëve me njohuritë e kërkuara. Megjithatë, për të arritur një standard më të lartë, është e nevojshme që pedagogët të vazhdojnë të rishikojnë dhe pasurojnë kurikulat e tyre.

Nevoja për përmirësimin e komunikimit të pedagogëve në auditor:

35-65% e studentëve theksojnë nevojën për përmirësimin e komunikimit nga ana e pedagogëve, ndërsa 35-55% janë të kënaqur me të. Kjo tregon se, ndërsa një numër i konsiderueshëm studentësh ndihen të kënaqur me komunikimin aktual, ekziston një pjesë e madhe që kërkon përmirësime. Një përmirësim i komunikimit do të kontribuonte në një atmosferë më interaktive dhe më të ngrohtë gjatë leksioneve.

Aftësimi praktik nga detyrat e kursit:

80-85% e studentëve pajtohen se detyrat e kursit i aftësojnë praktikisht, ndërsa 120% kanë një vlerësim më të ulët për këtë aspekt. Ky rezultat sugjeron që shumica e

studentëve i shohin detyrat e kursit si të dobishme për zhvillimin e aftësive praktike. Për të përmirësuar këtë aspekt, pedagogët mund të krijojnë detyra që janë edhe më të lidhura me aspekte praktikë dhe situata reale.

Të dhënat tregojnë se përmbajtja mësimore janë vlerësuar pozitivisht nga shumica e studentëve, por ka fusha ku përmirësimet mund të sjellin përfitime të mëdha, si ofrimi i më shumë literaturës shtesë dhe përmirësimi i komunikimit në auditor. Këto ndërhyrje do të ndihmonin në rritjen e cilësisë së përgjithshme të mësimdhënies.

Këto rezultate tregojnë se strukturimi i detyrave dhe organizimi i praktikave ka një ndikim të konsiderueshëm pozitiv në procesin e tyre të të nxënit.

Vlerësimi për praktikat mësimore/profesionale

Të dhënat për këtë pjesë të pyetësorit që u plotësua vetëm nga studentët e të ciklit të dytë, tregojnë rëndësinë e këtyre praktikave për përgatitjen e tyre për tregun e punës.

Nga të dhënat e analizuara për praktikat profesionale, 55-65% e studentëve e kanë vlerësuar përvojën e praktikës si shumë të vlefshme për aftësimin e tyre profesional, duke treguar se më shumë se gjysma kanë përfituar në mënyrë të konsiderueshme nga këto aktivitete. Nga ana tjetër, 10-35% e studentëve e kanë vlerësuar atë si pak të vlefshme, dhe 10-20% si aspak të vlefshme. Kjo përqindje sugjeron se, ndonëse shumica e studentëve ndihen të përgatitur nga praktikat e tyre, ka një përqindje të konsiderueshme që mendon se këto përvoja nuk i kanë plotësuar plotësisht pritshmëritë e tyre. Kjo tregon nevojën për një plan veprim për rishikim dhe përmirësim të strukturës dhe përmbajtjes së praktikave, për t'u siguruar që ato të jenë sa më të dobishme për të gjithë studentët dhe të adresojnë boshllëqet tek studentët që kanë evidentuar dhe vlerësuar praktikën më pak dhe aspak të vlefshme.

Analiza e faktorëve të praktikës profesionale bazuar në të dhënat e analizuara tregon një panoramë të rëndësishme për organizimin dhe efektivitetin e saj.

50-70% e studentëve pajtohen se praktika zhvillohet formalisht në institucione, ndërsa 32% nuk pajtohen. Ky rezultat tregon se, megjithëse shumica e studentëve e perceptojnë praktikën si nevojë e rëndësishme dhe e strukturuar sipas kërkesave të tregut të punës, ku lidhet aspekti teorik me atë praktik të specializimit të tyre, ka një përqindje të lartë të atyre që ndihen se praktika mund të jetë më e organizuar dhe më e qartë.

Vetëm 10-20% e studentëve janë të mendimit se frekuentojnë rrallë orët e praktikës për shkak të mungesës së interesit, ndërsa 75-78% e studentëve nuk pajtohen me këtë mendim. Kjo tregon se shumica e studentëve janë të interesuar për të marrë pjesë në praktika, duke sugjeruar që përmbajtja dhe struktura e tyre të jenë tërheqëse dhe të mbështesin angazhimin e studentëve. Ky është një aspekt pozitiv, që reflekton përkushtimin e studentëve ndaj procesit praktik të dijeve të fitura.

Një pjesë e madhe e studentëve, rreth 65-70% besojnë se njohuritë teorike të marra gjatë leksioneve janë të dobishme dhe mund të përdoren gjatë praktikave. Megjithatë, 15-30% e studentëve nuk pajtohen me këtë mendim. Kjo tregon se, ndonëse shumica e studentëve mund t'i zbatojnë njohuritë teorike në situata praktike, ka edhe një grup që

has vështirësi. Ndaj do të ishte me dobi të ofrohet mbështetje, komunikim dhe literaturë shtesë që të përmirësohet lidhja mes teorisë dhe praktikës. Kjo do të çonte në perceptimin e rëndësisë së praktikës, si dhe angazhimin dhe gjithëpërfshirjen e studentëve në të.

Vlerësimi i shërbimeve të Sekretarive Mësimore, Bibliotekave dhe Infrastrukturës

Nga të dhënat, bëhet fjalë për një vlerësim të cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës së ofruar nga institucioni arsimor. Aspektet e shqyrtuara përfshijnë komunikimin dhe sjelljen e stafit, përmbushjen e kërkesave të studentëve, disponueshmërinë e burimeve (bibliotekë, sekretari, laboratorë), si dhe kushtet infrastrukturore (auditorët, ndriçimi, mjetet mësimore, ngrohja, aksesin në internet dhe mjediset e jashtme).

Në përgjithësi, rezulton se shumë aspekte janë vlerësuar “**Shumë Mirë**”, duke reflektuar kënaqësi të lartë nga ana e studentëve. Veçanërisht, sjellja e stafit të bibliotekës dhe sekretarisë, funksionimi i laboratorëve, përmbushja e elementëve praktikë dhe kushtet mjedisore janë disa nga pikat më të forta. Kjo tregon se institucioni ka investuar në ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë dhe një ambient mbështetës për procesin e të nxënës.

Nga ana tjetër, disa fusha shfaqin vlerësime më të ulëta, duke përfshirë disa raste me vlerësimin “**Keq**”, veçanërisht në lidhje me ndriçimin, ngrohjen, dhe aksesin në internet. Këto rezultate sugjerojnë nevojën për ndërhyrje për përmirësimin e kushteve fizike dhe teknologjike që mbështesin procesin mësimor.

Në përgjithësi, të dhënat ofrojnë një pasqyrë të balancuar ku elementët kryesorë të funksionimit të institucionit janë të vlerësuar pozitivisht, por me disa sfida që kërkojnë vëmendje të veçantë për të përmirësuar përvojën studentore në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Komunikimi dhe sjellja e personelit ndihmës akademik:

Nga të dhënat e mbledhura, 40-50% e studentëve e vlerësojnë këtë aspekt si “Mirë” dhe 35-50% si “Shumë mirë”. Megjithatë, 10-15% e studentëve e vlerësojnë komunikimin dhe sjelljen si “Keq”, gjë që sugjeron se duhen përmirësuar dhe kontrolluar vazhdimisht komunikimet dhe shërbimet që sjellin këto përfundime gjetjesh në këtë fushë për të përmbushur plotësisht pritshmëritë e tyre.

Plotësimi i kërkesave të studentëve:

Të dhënat tregojnë se 45-55% e studentëve janë të kënaqur, duke e vlerësuar këtë aspekt si “Mirë”, ndërsa 23-43% e konsiderojnë si “Shumë mirë”. Për sa i përket vlerës prej 11-22% të studentëve që janë të pakënaqur, sugjerohet që kjo hapësirë e

konsiderueshme të ofrojë mundësi më të mira për përmirësimin e plotësimit të kërkesave të tyre, duke synuar në rritjen e cilësisë së përgjithshme të shërbimit.

Disponueshmëria në sekretari dhe bibliotekë:

Ky aspekt është vlerësuar si “Mirë” nga 54% e studentëve dhe “Shumë mirë” nga 28%, që do të thotë se 82% janë të kënaqur me disponueshmërinë e shërbimeve. Megjithatë, 18% e studentëve e konsiderojnë këtë aspekt si “Keq”, duke treguar nevojën për më shumë akses dhe përgjigje më të shpejta ndaj nevojave të studentëve.

Komunikimi dhe sjellja në sekretari dhe bibliotekë:

40-50% e studentëve e vlerësojnë këtë aspekt si “Mirë” dhe 40-46% si “Shumë mirë”. Vetëm 12-15% janë të pakënaqur me komunikimin dhe sjelljen në këto ambiente e për pasojë nuk ndihen të mbështetur nga stafi.

Përgjithësisht, studentët shfaqin vlerësime pozitive për komunikimin, sjelljen, dhe mbështetjen e ofruar nga sekretaritë dhe bibliotekat. Megjithatë, përqindjet e pakënaqësisë në disa aspekte tregojnë për nevojën për përmirësime, veçanërisht në plotësimin e kërkesave të studentëve dhe disponueshmërinë e shërbimeve. Përpjekjet për të adresuar dhe për t'i minimizuar këto shqetësime mund të rrisin më tej cilësinë e shërbimeve.

Auditorët, ndriçimi, mjetet mësimore dhe ngrohja:

Të dhënat tregojnë se 30-40% e studentëve vlerësojnë këto elemente si “Mirë” dhe 40% si “Shumë mirë”. Ndërkohë, 6-18% e studentëve shprehen se këto aspekte janë “Keq”, gjë që tregon për mundësinë e përmirësimeve në auditorë për të përmbushur pritshmëritë e studentëve. Për këtë duhet të bëhen kontrole teknike të vazhdueshme për t'u paraprirë parregullsiave infrastrukturore që ndikojnë drejtpërdrejt në mësimdhënien në standarde komode dhe bashkëkohore.

Mjediset e jashtme:

Ky aspekt ka një vlerësim të lartë, ku 30-50% e studentëve e vlerësojnë si “Mirë” dhe 37-45% si “Shumë mirë”. Vetëm një përqindje e vogël shprehin pakënaqësi, duke treguar se mjediset e jashtme konsiderohen përgjithësisht të mira.

Aksesi në internet:

Rezultatet për aksesin në internet janë më kritike, pasi 23-49% e studentëve e vlerësojnë këtë shërbim si “Keq”. Ndërsa, 36-39% e vlerësojnë si “Mirë” dhe vetëm 15-38% si “Shumë mirë”. Kjo përqindje e lartë e pakënaqësisë tregon për një nevojë të fortë për

përmirësime në ofrimin e shërbimit të internetit, i cili është një faktor thelbësor për përvojën akademike të studentëve.

Vlerësimi për shërbimet e bibliotekave dhe laboratoreve

Funksionimi i laboratorëve:

43-49% e studentëve e vlerësojnë funksionimin e laboratorëve si “Mirë” dhe 22-33% si “Shumë mirë”, por 18-35% e konsiderojnë këtë aspekt si “Këq”. Kjo sugjeron se, edhe pse shumica janë të kënaqur, ka një përqindje të konsiderueshme që tregon për nevojën për përmirësim të pajisjeve dhe funksionalitetit të laboratorëve.

Përmbushja e elementëve gjatë orëve laboratorike:

Të dhënat tregojnë se 46-49% e studentëve e vlerësojnë këtë aspekt si “Mirë” dhe 18-32% si “Shumë mirë”, ndërsa 19-36% janë të pakënaqur dhe e konsiderojnë si “Këq”. Këto vlera të përafërta përqindjesh, që lidhen me përdorimin e drejtpërdrejtë të laboratorëve në mësimdhënien dhe mësimnxënien në arsimin e lartë, paraqiten si tregues dhe indikatorë realë për nevojën dhe domosdoshmërinë e përmirësimit të metodave dhe resurseve gjatë orëve laboratorike, për të siguruar një përvojë më efikase dhe më të dobishme për studentët.

Përmirësimet në këto fusha mund të ndikojnë pozitivisht në përvojën e përgjithshme të studentëve dhe cilësinë e arsimit në fakultet.

Ndërsa shumica e studentëve shfaqin një nivel të lartë kënaqësie me mjediset e jashtme dhe disa aspekte të auditorëve dhe laboratorëve, aksesit në internet dhe përmbushja e nevojave gjatë orëve laboratorike kërkojnë vëmendje të veçantë. Përmirësimet në këto fusha mund të ndikojnë pozitivisht në përvojën e përgjithshme të studentëve dhe cilësinë e arsimit në fakultet.

Për të ilustruar këto rezultate më qartë, tabela dhe grafiku i mëposhtme do të paraqesin përqindjet dhe shpërndarjen e përgjigjeve, duke ndihmuar në identifikimin vizual të fushave me performancë më të lartë dhe ato që kërkojnë më shumë vëmendje.

Raste të korrupsionit

Rreth 90-95% e studentëve e kanë mohuar mundësinë e korrupsionit ndërsa rreth 5-10% pohon forma dhe mënyra të ndryshme të favorizimit.

FB 100% JO

Nuk ka asnjë rast të përmendur.

Ky numër studentësh që kanë thënë se nuk kanë paguar për të marrë provime, tregon se në Fakultetin e Bujqësisë ka një kulturë të mirë dhe të ndershme rreth trajtimit të studentëve dhe një praktikë të mirë në luftën kundër korrupsionit.

FEF 95% JO 5% PO

FE 85% JO 15% PO

Në lidhje me pyetjen e hapur që ka identifikuar raste të pedagogëve që mund të kenë vepruar në shkelje të rregullores, ky raport përmban vetëm statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga tërësia e përgjigjeve të studentëve. Sipas rezultateve të pyetësorit, 15% e përgjigjeve tregojnë për raste të sjelljeve të papërshtatshme nga pedagogë, që përfshijnë trajtimin e studentëve në mënyrë të pabarabartë dhe çështje të tjera të komunikimit dhe profesionalizmit.

Raportet individuale për secilin pedagog të përmendur në komentet e studentëve janë dërguar nga NJBSC-ja tek Dekani i fakultetit. Dekani do të diskutojë këto gjetje me stafin akademik për të shqyrtuar situatën dhe për të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe respektimin e rregullores.

FSHNSHH 92% JO 6% PO 2% Pa përgjigje

Rastet e korrupsionit janë të pranishme në fakultetin tonë, ndonëse në masa dhe shifra shumë të ulëta. Ndonëse ky fenomen haset në përmasa të tilla, vetëm nga **12 studentë**, përsëri ai duhet luftuar me forcë dhe duhen gjetur mjetet e duhura për ta eliminuar tërësisht, detyrë kjo e organeve drejtuese të fakultetit dhe më gjerë. Kjo për vetë faktin se ky fenomen thellohet kur analizoj të dhënat e pyetësorit lidhur me format e mitmarrjes nga ku rezulton se numri i studentëve që ka përdorur njërin nga format e sugjeruara nga pyetësi, është edhe më lartë, **15 studentë** nga **12 studentë** që përmenda më sipër. Konkretisht:

- a) **2 studentë** pohojnë se kanë paguar duke ia dhënë në dorë pedagogut
- b) **8 studentë** pohojnë se kanë përdorur sekserë
- c) **5 studentë** duke i favorizuar në forma të tjera, por që nuk specifikohen se çfarë.

REKOMANDIME NGA FAKULTETET

Fakulteti i Bujqësisë

Rekomandime për mjetet mësimore:

Ka fusha që kërkojnë përmirësime, veçanërisht:

1. Përdorimi më i mirë i mjeteve mësimore.
2. Rritja e lidhjes mes teorisë dhe praktikës.
3. Optimizimi i menaxhimit të kohës gjatë mësimit.

Rishikimi i këtyre fushave mund të përmirësojë më tej cilësinë e mësimdhënies dhe të adresojë plotësisht nevojat e studentëve

Rekomandime për performancën e pedagogëve:

- **Forcimi i pjesëmarrjes në orët mësimore:** Universiteti mund të eksplorojë strategji për rritjen e motivimit dhe pjesëmarrjes së studentëve.
- **Rritja e mbështetjes pedagogjike:** Pedagogët mund të trajnohen për të përmirësuar mbështetjen e ofruar ndaj studentëve, veçanërisht në ato fusha ku ata ndihen të pasigurt.
- **Përmirësimi i lëndëve që konsiderohen më pak ndihmuese:** Identifikimi i lëndëve problematike dhe përshtatja e tyre me nevojat e studentëve.

Kjo analizë tregon se, ndërsa përvoja e përgjithshme është pozitive, ka fusha për përmirësim që universiteti mund të adresojë për të rritur kënaqësinë e studentëve dhe efektivitetin e mësimdhënies.

Rekomandime për shërbimet dhe infrastrukturën:

Bazuar në analizën e të dhënave, rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës në institucionin arsimor përfshijnë:

1. Përmirësimi i kushteve infrastrukturore:

- **Ndriçimi dhe ngrohja:** Investime në ndriçim adekuat dhe sisteme efektive ngrohjeje në auditorë për të garantuar një ambient të përshtatshëm për të nxënit.
- **Mjediset e jashtme:** Mirëmbajtja dhe pasurimi i hapësirave të jashtme për t'u bërë më funksionale dhe tërheqëse për studentët.

2. Rritja e aksesit në teknologji:

- **Internet më i shpejtë dhe i qëndrueshëm:** Zgjerimi i mbulimit të rrjetit Wi-Fi dhe përmirësimi i cilësisë së internetit për të përmbushur kërkesat e studentëve dhe stafit.
- **Pajisjet e laboratorëve:** Modernizimi i pajisjeve laboratorike për të siguruar një përvojë praktike më efektive gjatë orëve laboratorike.

3. Mbështetja dhe komunikimi:

- **Trajnimi i stafit të bibliotekës dhe sekretarisë:** Sigurimi i trajnimeve të rregullta për përmirësimin e komunikimit dhe sjelljes ndaj studentëve.
- **Përmbushja e kërkesave të studentëve:** Hartimi i mekanizmave më të qartë dhe më të shpejtë për adresimin e kërkesave dhe nevojave të studentëve.

4. Rritja e angazhimit për praktikën mësimore:

- **Sigurimi që elementët praktikë të përfshihen në mënyrë të plotë dhe të strukturuar gjatë orëve laboratorike dhe praktike, duke u fokusuar në lidhjen e teorisë me praktikën.**

Rezultatet tregojnë se Fakulteti i Bujqësisë ka një klimë të mirë të besimit mes studentëve dhe drejtuesve të tij dhe se studentët kanë bindjen se ata do të trajtohen me të njëjtin standard të barabartë. Nëse Fakulteti i Bujqësisë dëshiron të vazhdojë këtë rrugë, është shumë e rëndësishme që të vazhdojë të luftojë kundër korrupsionit dhe të mbajë kulturën e ndershmërisë dhe besimit tek studentët e tij.

Rezultatet e mbledhura nga ky pyetësor nuk reflektojnë plotësisht opinionin e gjithë studentëve të Fakultetit të Bujqësisë, për shkak të një pjesëmarrjeje më të ulët se sa numri i përgjithshëm i studentëve

Fakulteti Ekonomik

Njësia e Brendëshme e Sigurimit të Cilësisë, pasi ka shqyrtuar përgjigjet e studentëve në këtë pyetësor dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve i rekomandon:

Bazuar në analizën e raportit të pyetësorit të studentëve, evidentohen disa problematika kryesore që kërkojnë vëmendje për përmirësim. Këto problematika përfaqësojnë aspekte ku perceptimi i studentëve është më i ulët dhe ku ata kanë identifikuar sfida specifike në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe mbështetjes akademike dhe rekomandon:

Një nga sfidat kryesore është pjesëmarrja e ulët e studentëve në plotësimin e pyetësorit, gjë që mund të ndikojë në saktësinë dhe përfaqësimin e përgjithshëm të vlerësimeve. Kjo tregon për një mungesë të ndërgjegjësimit apo motivimit të studentëve për të shfrytëzuar këtë mundësi për të dhënë mendimin e tyre mbi përvojën mësimore.

Raporti tregon se studentët kanë shprehur shqetësime në lidhje me mungesën ose pamjaftueshmërinë e literaturës së rekomanduar dhe të mjeteve teknologjike që përdoren në mësimdhënie. Ky problem përbën një pengesë në mbështetjen akademike që ofrohet, duke ndikuar negativisht në përgatitjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në procesin mësimor.

Një pjesë e konsiderueshme e studentëve kanë vlerësuar negativisht efektivitetin e metodave të mësimdhënies të aplikuara nga disa pedagogë. Kjo përfshin mungesën e përfshirjes aktive të studentëve gjatë orëve të mësimi, gjë që ndikon në angazhimin dhe motivimin e tyre për të marrë pjesë aktive në procesin mësimor.

Studentët kanë përmendur që atmosfera e krijuar nga disa pedagogë në auditor nuk është gjithmonë mbështetëse dhe motivuese. Ka raste për sjellje që nuk i përmbahen standardeve të sjelljes profesionale, çka ndikon në gjendjen emocionale të studentëve dhe në dëshirën e tyre për të bashkëpunuar gjatë orëve të mësimi.

Disa pedagogë janë vlerësuar si të papërgatitur profesionalisht ose kanë vështirësi në menaxhimin efektiv të kohës gjatë orës së mësimi, çka ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe në arritjen e objektivave të kursit. Kjo problematikë vë në pah nevojën për përgatitje më të mirë të pedagogëve për të menaxhuar kohën në mënyrë që të përmbushen të gjitha temat e planifikuara në mënyrë të plotë.

Studentët kanë raportuar sfida në përfshirjen në praktika profesionale të strukturuar dhe me mbështetje të mjaftueshme. Praktika profesionale është e rëndësishme për të siguruar që studentët të përfitojnë nga përvoja praktike dhe të përgatiten për tregun e punës, por mungesa e koordinimit, mbikëqyrjes, dhe mbështetjes së mjaftueshme gjatë praktikës e redukton efektivitetin e saj dhe ndikon në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.

Studentët kanë raportuar që interneti në mjediset e universitetit është shpesh i ngadalshëm, me ndërprerje të shpeshta ose i pamjaftueshëm për nevojat e tyre. Kjo mungesë e aksesit në një lidhje interneti të qëndrueshme dhe të shpejtë ndikon negativisht në cilësinë e studimeve dhe zvogëlon mundësinë e përvetësimit të informacionit në kohë reale.

Studentët janë përballur me mungesa të pajisjeve teknologjike moderne, si kompjuterët, projektorët dhe tabelat interaktive në auditore. Pajisjet ekzistuese janë shpesh të vjetruara ose jo funksionale, gjë që kufizon mundësinë e shfrytëzimit të teknologjisë gjatë mësimi. Kjo mungesë e infrastrukturës teknologjike pengon pedagogët dhe studentët të përdorin metodat e reja të mësimdhënies që përfshijnë mjete digjitale dhe mundëson përfshirjen e tyre në përmbajtjen mësimore.

Një tjetër problematikë e identifikuar është qëndrimi dhe disponibiliteti i stafit ndihmës akademik, i cili nga studentët është perceptuar si jo mjaftueshëm mbështetës. Ky perceptim mund të ndikojë në cilësinë e shërbimeve mbështetëse të ofruara, duke

kufizuar përkrahjen që studentët kanë në trajtimin e çështjeve administrative dhe akademike.

Këto problematika kërkojnë masa specifike për të përmirësuar përvojën mësimore të studentëve dhe për të përmbushur pritshmëritë e tyre ndaj institucionit dhe stafit akademik.

Në lidhje me pyetjen e hapur që ka identifikuar raste të pedagogëve që mund të kenë vepruar në shkelje të rregullores, ky raport përmban vetëm statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga tërësia e përgjigjeve të studentëve. Sipas rezultateve të pyetësorit, 15% e përgjigjeve tregojnë për raste të sjelljeve të papërshtatshme nga pedagogë, që përfshijnë trajtimin e studentëve në mënyrë të pabarabartë dhe çështje të tjera të komunikimit dhe profesionalizmit.

Raportet individuale për secilin pedagog të përmendur në komentet e studentëve janë dërguar nga NJBSC-ja tek Dekani i fakultetit. Dekani do të diskutojë këto gjetje me stafin akademik për të shqyrtuar situatën dhe për të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe respektimin e rregullores.

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

Njësia e Brendëshme e Sigurimit të Cilësisë, pasi ka shqyrtuar përgjigjet e studentëve në këtë pyetësor dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve rekomandon:

Bazuar në analizën e raportit të pyetësorit të studentëve, evidentohen disa problematika kryesore që kërkojnë vëmendje për përmirësim. Këto problematika përfaqësojnë aspekte ku perceptimi i studentëve është më i ulët dhe ku ata kanë identifikuar sfida specifike në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe mbështetjes akademike.

Një nga sfidat kryesore është pjesëmarrja e ulët e studentëve në plotësimin e pyetësorit, gjë që mund të ndikojë në saktësinë dhe përfaqësimin e përgjithshëm të vlerësimeve. Kjo tregon për një mungesë të ndërgjegjësimit apo motivimit të studentëve për të shfrytëzuar këtë mundësi për të dhënë mendimin e tyre mbi përvojën mësimore.

Mungesa e literaturës dhe mjeteve teknologjike

- Studentët shprehin shqetësime për mungesën ose pamjaftueshmërinë e literaturës së rekomanduar dhe mjeteve teknologjike në procesin mësimor.
- Ky problem krijon pengesa për mbështetje akademike dhe ndikon në përgatitjen dhe angazhimin e studentëve.
- Nevojitet akses i plotë me internet i auditorëve dhe laboratorëve mësimorë.

Vlerësimi negativ i metodave të mësimdhënies

- Një pjesë e madhe e studentëve vlerësojnë negativisht efektivitetin e metodave të përdorura.
- Mungesa e përfshirjes aktive të studentëve gjatë mësimit është një faktor që ndikon në angazhimin dhe motivimin e tyre.

Praktika profesionale

- Studentët kanë raportuar përfshirjen në praktika profesionale të strukturuar dhe me mbështetje të mjaftueshme.
- Kërkohej nga vlerësimet dhe mendimet e tyre lidhja teori-praktikë.
- Nevojitet që studentët të përfitojnë nga përvoja praktike dhe të përgatiten për tregun e punës

Atmosfera dhe sjellja e pedagogeve

- Atmosfera në auditor duhet të jetë më tepër mbështetëse dhe motivuese.
- Duhet korrigjuar raste të sjelljeve që nuk i përmbahen standardeve profesionale, çka i demotivon studentët dhe ju zbeh dëshirën për të bashkëpunuar.
- Trajnime të vazhdueshme duhen ndërmarrë si për stafin akademik dhe për atë ndihmës akademik me fokus sjelljen etike dhe profesionale në universitet.

Përmirësimi i organizimit të praktikave, komunikimi i vazhdueshëm me institucionet pritëse dhe mësuesit mentorë mund të ndihmojnë në evidentimin e vështirësive dhe faktorëve të tjerë të mundshëm që ata cilësojnë si tregues të këtyre mendimeve dhe sjelljeve nga ana e studentëve praktikantë. Këto akte ndërvepruese mund të rrisin interesin dhe përfshirjen e studentëve. Për më tepër, duke ofruar zgjedhje konkrete për këto shqetësime, synojnë të përmirësojnë cilësinë e përgjithshme të përvojës praktike, ashtu dhe të aftësojnë studentët të zhvillohen më së miri në fushën e tyre.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane

Përdorimi i internetit në funksion të mësimi është një aspekt që ka nevojë për përmirësime të mëtejshme, sidomos për të adresuar mendimet e studentëve që kanë përvoja negative. Kjo nënkupton nevojën për investime në infrastrukturën teknologjike, trajnime për pedagogët për përdorimin e mjeteve digjitale dhe rishikim të politikave të përdorimit të internetit për të maksimizuar përfitimet e tij në procesin mësimor.

Efektiviteti i metodave të mësimdhënies, përdorimi i mjeteve mësimore dhe lidhja teori-praktikë kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme. Përpjekjet për të adresuar këto fusha do të ndihmonin në rritjen e cilësisë së përgjithshme të mësimdhënies dhe përvojës studentore.

Përsa i përket literaturës të dhënat tregojnë se përmbajtja mësimore është vlerësuar pozitivisht nga shumica e studentëve, por ka vend ku përmirësimet mund të sjellin përfitime edhe më të mëdha, si ofrimi i më shumë literaturës shtesë dhe përmirësimi i komunikimit në auditor. Këto ndërhyrje do të ndihmonin në rritjen e cilësisë së përgjithshme të mësimdhënies.

Fakulteti ka në përbërjen e vet disa departamente, të cilët në specifikën e vet kanë një lidhje koherente dhe logjike të lidhur ngushtë me zhvillimin e praktikës mësimore,

sepse edhe diplomimi i studentëve sipas programeve të studimit bëhet në lidhje me ato profesione me të cilat zhvillimi i praktikës mësimore është vendimtar, siç janë profesioni i infermierit të përgjithshëm ose profesioni i mësimdhënësit.

Komente të përgjithshme nga studentët

- Ofendime dhe rëndese psikologjike në departamentin e infermierisë.
- Detyrim për të blerë dispencat me penalizim në pikët e vlerësimit të vazhduar.
- Mungesë korrektësie me orarin dhe zhvillimin e orëve nga pedagogët.
- Vlerësim i padrejtë.
- Shpresë për marrje në konsideratë të mendimeve të studentëve sidomos me sjelljet e pedagogëve.
- Korrigjimi me clean score është i padobishëm, korupsioni e gjen gjithmonë zgjidhjen.
- Sjellja e personelit ndihmës akademik.

Krahas pohimeve më sipër ka dhe komente që shprehen të kënaqur dhe pozitivë kryesisht nga FEF dhe FB.

NJSBC UNIKO

Dr. Juliana Çyfeku

Dr. Aldona Minga

Dr. Landi Gushi

Dr. Ardian Matka

Dr. Evis Kapurani (Sektori i Kurrikulave dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë)

Xhovani Saraçi (Drejtoria Ekonomike)

Edona Kalludra (Studente)

Konceptoi: Evis Kapurani